

**AKT THEMELIMI
PER SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“DESIGNO ART” SHPK**

Sot, më datën 16.12.2022, personaisht::

(i) Z. Hasan Sheku i biri Zyber dhe Bedrie lindur në 17.03.1955 në Tiranë dhe banues në Tiranë në adresën Rr Hodo Beg nr 10 Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me nr 036823357 dhe nr personal F50317025U, shtetas shqiptar madhor, me zotësi të plotë për të vepruar

themelon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe redakton këtë Akti Themelimi për shoqërinë tregtare si më poshtë.

Bazuar në :

- Ligjin nr.9901 date 14.04.2008 “Per tregtarët dhe shoqerite tregtare”
- Kodi Civil I Republikës së Shqipërisë miratuar me ligjin Nr, 7850 date 29.07.199 (indrshuar)
- Ligji nr 9723 Dt 03.05.2007 Për Qëndren Kombëtare të Biznesit
- Si edhe të gjithë legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë

hartohet ky Akt Themelimi për krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar me kushtet si më poshtë:

Neni 1

Themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “DESIGNO ART” shpk, me ortak themelues si më poshtë:

((i) Z. Hasan Sheku i biri Zyber dhe Bedrie lindur në 17.03.1955 në Tiranë dhe banues në Tiranë në adresën Rr Hodo Beg nr 10 Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me nr 036823357 dhe nr personal F50317025U, shtetas shqiptar madhor, me zotësi të plotë për të vepruar.

Neni 2

Shoqëria ka selinë e saj në Tiranë, në adresën: Rr Ish Fusha e Aviacionit, Kompleksi Garden Residence Turdiu, Godina B, Nr AP 22 e cila mund të ndryshojë në perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 3

Shoqëria themelohet për të vepruar në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me afat të pacaktuar.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:



Krijim, dizenjim dhe mirembajtje faqe web-esh. Sherbime, Konsulence zhvillim, menaxhim, asistence teknike, marketing i website të ndryshme, internet marketing, si edhe cdo aktiviteti të lejuar nga ligji që lidhet direkt ose indirekt me objektin e shoqërisë.

Neni 5

Kapitali themeltar është 1,000 lek (një mijë lek), i nënshkruar në të holla nga Ortaku i vetem themelues i shoqërisë, që i korrespondon 100% (një qind për qind) të kapitalit të shoqërisë.

Kapitali përbëhet nga 1 (një) kuotë e nënshkruar dhe e shlyer plotësisht me vlerë totale prej 1000 lekë (një mijë lek), nga ortaku themelues

Neni 6

Ortaku i vetëm themelues i shoqërisë tregtare me pergjegjesi të kufizuar **DESIGNO ART Sh.p.k** zotëron kuotën në këtë shoqëri si më poshtë

Z. Hasan Sheku, shtetas shqiptar madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, ortak i vetem themelues, lloji i kontributit në para, vlera e kontributit 1.000 (një mijë) lek zotërues i 100% (një qind për qind) të kapitalit, numri i kuotave 1(një).

Neni 7

Referuar ligjit nr 9901 date 14.04.2008 “Per tregtarët dhe shoqërite tregtare” organet drejtuese të shoqërisë janë :

Ortaku i Vetem - organi më i lartë vendimarrës

Administratori - organi ekektiv dhe administrativ i shoqërisë

Neni 8

1. Veprimtaria e shoqërisë drejtohet nga administratori i cili zgjidhet nga organi më i lartë vendimarrës
2. Numri i Administratorëve do të jetë 1.
3. Administratori i parë i shoqërisë emërohet **Z. Hasan Zyber Sheku** lindur në 17.03.1955 në Tiranë dhe banues në Tiranë në adresën Rr Hodo Beg nr 10 Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me nr 036823357 dhe nr personal F50317025U, shtetas shqiptar madhor, me zotësi të plotë për të vepruar
4. Administratori zgjidhet për një periudhë 5 (pesë) vjecare me të drejtë riemerimi

Neni 9

Shoqëria mund ta mbyll aktivitetin e saj ne rastet kur:

- a) Vendos Ortaku i vetem ose Asambleja e Përgjithshme.
- b) Me hapjen e procedurave të falimentimit
- c) Në baze të ligjit vendoset likuidimi i shoqërisë.



d) Sipas parashikimeve të tjera të nenit 99 të ligjit

Neni 10

Dispozita më të hollësishme për veprimtarinë e shoqërisë përcaktohen në Statutin e saj.

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku i vetëm themelues u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua. Ky akt themelimi hartohet në gjuhën shqipe.

ORTAKET I VETËM THEMELUES

Z. Hasan SHEKU

Hasan Sheku 